



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT KRYETARI

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit". Tiranë. Tel-Fax: 04 232-491

Nr. 259/18 Prot.

Tiranë, më 30/06/ 2017

V E N D I M

Nr. 78, Datë 30/06/2017

**PËR
AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË URA-VAJGURORE DHE 3
ISH- KOMUNAT KUTALLI, CUKALAT DHE POSHNJË, ME OBJEKT
"MBI AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË DHE LIGJSHMËRISË
FINANCIARE"**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditivit dhe zbatimin e standardeve nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15 dhe 30, të ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Mbi auditimin e përputhshmërisë dhe ligjshmërisë financiare" të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore për periudhën 01.01.2014 deri më 31.12.2016 dhe 3 njësive administrative ish-Komunat Kutalli, Cukalat dhe Poshnje për periudhën 01.01.2013 deri më 31.07.2015.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se Bashkia Ura-Vajguore në fund të vitit 2016 ka një nivel borxhi ndaj të tretëve, detyrime për mallra, shërbime dhe punime në vlerën **78,419,082 lekë**.

1.1 Rekomandimi: Bashkia Ura-Vajguore për vitin 2017 të marrë masa për shlyerjen e borxhit në vlerën **78,419,082 lekë**, përmes një planifikimi të kujdesshëm për reduktimin e shpenzimeve si dhe duke rritur të ardhurat vendore, me qëllim përmirësimin e situatës të likuiditeteve.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Bashkia Ura-Vajguore ka vlerën debitorë në shumën **7,222,599 lekë**, për arkëtimin e të cilës nuk është marrë dhe iniciuar asnjë procedurë ligjore.

2.1 Rekomandimi: Bashkia Ura-Vajguore të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **7,222,599 lekë**, sipas listave analitike që disponohen në financën e bashkisë.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i bilancit të vitit 2015 të Bashkisë Ura-Vajguore, u konstatua se mungon centralizatori, për mënyrën e mbylljes së llogarive, pozicionin dhe kuadrumin e tyre, për bashkimin e të dhënave kontabël me ish-komunat Cukalat, Kutalli dhe Poshnje në një të vetme, në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin”. Amortizimi vjetor në bilancin e vitit 2016 nuk është pasqyruar saktë, pasi tek llogaria e amortizimit është përfshirë padrejtësisht edhe vlera e plotë e materialeve jashtë përdorimit në shumën 21,329,372.

3.1 Rekomandimi: Bashkia Ura-Vajguore me mbylljen e pasqyrave financiare 2017 (bilancin kontabël) të marrë masa për saktësimin dhe sistemimin e vlerës së amortizimit vjetor të pasqyruar gabim në bilancin e vitit 2016.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i shpenzimeve të pastrimit të qytetit, u konstatua se nuk disponohet analizë ekonomike-financiare për efektivitetin ekonomik të shërbimit të pastrimit, me sipërmarrje private apo nën administrimin e bashkisë, për efekt të disiplinimit të shpenzimeve dhe përdorimit tyre me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet, pasi administrimi i këtij shërbimi nuk është përqendruar në një formë organizimi, por ka qenë me lëvizje për periudhën e auditimit 2013-2016 njëherë me sipërmarrje private dhe më tej është mbuluar nga Bashkia, ndërsa përsëri ka kaluar me sipërmarrje private, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e Aktiviteteve në Njësinë e Sektorit Publik” dhe me ligjin nr. 10279, datë 08.07.2010 “Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

4.1 Rekomandimi: Bashkia Ura-Vajguore të marrë masa të administrojë shërbimin e pastrimit të qytetit me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet, duke kryer analizë ekonomike-financiare për efektivitetin ekonomik të shërbimit të pastrimit me sipërmarrje private apo nën administrimin e bashkisë.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se emërimi i disa inspektorëve të IMTV është kryer jashtë profesionit të kërkuar, në kundërshtim me nenin 11 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit” ndryshuar me ligjin nr. 183/2014 datë 24.12.2014 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”.

5.1 Rekomandimi: Bashkia Ura-Vajguore të marrë masa të zvendësojë inspektorët e IMTV që janë emëruar jashtë profesionit të kërkuar, në zbatim të kriterëve të përcaktuara në nenin 11, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”, i ndryshuar.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), por nuk ka funksionuar. Nuk është hartuar plani strategjik i menaxhimit financiar, ku të përfshihej misioni, vizioni, objektivat dhe plan-veprimet afatshkurtëra. Nga menaxheri i njësisë vendore nuk ishin marrë masa trajnuese për njohjen e këtij ligji dhe vënien në zbatim të tij me qëllim zbatimin sa më të mirë të tyre në praktikë për menaxhimin e riskut për realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ai drejton. Në këto kushte në mbyllje të aktivitetit vjetor të Bashkisë deklarata e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm, raporti vjetor për funksionimin e kontrollit të brendshëm dhe pyetëtori i vetëvlerësimit të komponentëve të MFK janë të mangëta dhe nuk pasqyrojnë me vërtetësi realitetin e vlerësimit e gjendjes së sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".

6.1 Rekomandimi: Bashkia Ura Vajguore të marrë masa për njohjen nga menaxheri dhe stafi drejtues të MFK dhe komponentëve të tij, për ngritjen e një sistemi të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe përcaktim të metodologjisë për zbatimin e tij, për hartimin e një plan-veprimi konkret, ku të jenë përfshirë hapat që duhen ndjekur dhe masat që duhen marrë për ngritjen e sistemeve të përshtatshme të MFK-së, përfshirë identifikimin dhe menaxhimin e riskut në një linjë me hartimin e programit ekonomik. Në planet konkrete të veprimit të përcaktohen objektivat, prioritetet me afatet kohore dhe personat përgjegjës për realizimin e tyre. Në fund të periudhës ushtrimore të bëhet vetëvlerësimi dhe të raportohet për funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga ish-Komunën Cukalat për periudhën 2013-2014 e 6-mujorin e parë të vitit 2015 në bazë të strukturave organike të miratuara për vitet përkatëse dhe urdhrave të Titullarit janë rekrutuar dhe bërë pagesa për çdo muaj për punonjës pastrimi me kontratë të përkohshme në një total prej 1,395,615 lekë. Niveli i pagesës është nën vlerën e pagës minimale prej 22,000 lekë (të përcaktuar në sipas VKM nr. 573, datë 3.7.2013) dhe është përballuar nga fondet e zërit të shpenzimeve të buxhetit art. 602 "shpenzime operative". Për këto punonjës nga Punëdhënësi është ndalur dhe derdhur tatimi në burim, por nuk janë ndalur dhe derdhur kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për arsye të nivelit të pagës. Punësimi i këtyre punonjësve në këtë formë, pa i deklaruar ato në Institutin e Sigurimeve Shoqërore, duke iu shmangur detyrimeve të pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, është në kundërshtim me nenet 13 pika 2 dhe 79 të ligjit nr. 7703 datë 11.05.1993 "Për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësor" i ndryshuar duke shkaktuar **të ardhura të munguara për skemën e sigurimeve në shumën 1,104,864 lekë.**

7.1 Rekomandimi: Bashkia Ura Vajguore të eliminojë praktikën e pasakta të punësimit të punonjësve si dhe të kryej rregullisht pagesën e detyrimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Mungojnë programe të plota financiare afatmesme (PBA) në kundërshtim me UMF nr. 7/1, datë 29.02.2012 dhe nr. 9/1 datë 25.02.2013 "Për përgatitjen e buxhetit vendor", nr. 7, datë 28.04.2014 "Për përgatitjen e PBA 2015-2017" dhe nr. 7 datë 13.2.2015 "Për përgatitjen e PBA 2016-2018". Programet buxhetore vjetore janë paraqitur për miratim në Këshillin e Bashkisë vetëm duke përshkruar të dhënat tabelore, pa një analizë të hollësishme për aftësinë paguese të Bashkisë, me një planifikim të pastudiuar dhe të fryrë pa bazë reale të të ardhurave. Mungojnë raportet periodike të monitorimit të buxhetit të paraqitura pranë Këshillit të Komunës sa përcaktuar në UMF nr. 2 datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar.

8.1 Rekomandimi: Bashkia Ura Vajgurore të marrë masa për ngritjen e grupit të punës për hartimin e programit të zhvillimit ekonomik afatmesëm dhe atij vjetor të mirëstuduar, hartimin dhe planifikimin e treguesve, të bazuar mbi hartimin më parë të planit strategjik të zhvillimit, ku të jenë përcaktuar objektiva të qarta, fushat prioritare, projektet, i detajuar në programe mujore si dhe të ndjekë e të monitorojë realizimin e tij, duke bërë analizën faktoriale dhe rekomandimin e masave për përmirësimin e gjendjes.

Në vazhdimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga ish-Komunëna Cukalat në 10 raste në vlerën 1,080,749 lekë të blerjeve të vogla për punime mirëmbajtje të rrugëve, kanaleve e mureve mbajtjes nuk është argumentuar nevoja e blerjes dhe nuk është përcaktuar i plotë objekti i prokurimit, pasi nuk janë përcaktuar akset rrugore apo vendet ku do të kryhen punimet, si dhe preventivat apo situacionet janë të pashoqëruara me projekt-skice dhe plan-vendosje, në kundërshtim me nenet 1, 3/9 dhe 23/4 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, me Kreun V pika 1/c, Kreun VI pika 2/a të VKM nr 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”; me nenet 40, 60-61VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin rregullave të prokurimit publik” dhe Kreu I pikën 3.1 dhe 8.3 të UKM nr. 2 datë 13.05.2005 në zbatim të ligjit nr 8402, datë 17.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar.

9.1 Rekomandimi: Bashkia Ura Vajgurore të marrë të mos lejojë praktika të tilla që shoqërohen me risk të lartë, në procedurat e blerjeve dhe shërbimeve me vlera të vogla, duke shoqëruar preventivat me skica, fotografi para dhe pas punimeve për vërtetimin e punimeve.

Në vazhdimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga ish-Komunat Poshnje dhe Cukalat janë kryer pagesa për shpenzim udhëtim e dieta për punonjësit e administratës dhe ish-Kryetarin, pa përcaktuar e detajuar qëllimin në autorizimet dhe urdhër-shërbimet e miratuara nga Titullari dhe pa dokumentacion mbështetës të shërbimit. Konkretisht, ish-Komuna Poshnje në vlerën 896,960 lekë dhe ish-Komuna Cukalat në vlerën 830,000 lekë në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” .

10.1 Rekomandimi: Bashkia Ura Vajgurore të marrë masa që në rastet e dërgimit me shërbim të punonjësve jashtë qendrës së punës të argumentojë arsyen e lëvizjes me dokumentacion justifikues, në mënyrë që të justifikohet puna që do të kryhet nga punonjësi.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Nga ish-Komuna Poshnje për periudhen 01.01.2013-30.06.2015 në 32 raste janë kryer pagesa në vlerën 1,037,200 lekë për marrje mjet me qira për pastrim të mbetjeve urbane në bazë të faturave përkatëse të lëshuar nga Personi Fizik “N.H.” posedues i mjetit. Sektori i Shërbimeve nuk ka kryer asnjë monitorim apo mbikqyrje e kryerjes së këtij shërbimi, në kundërshtim me kontratën pika 2 dhe me VKM nr.1 datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar Kreu VIII , pika 1/(d),Pika 2/a,b.

11.1 Rekomandimi: Bashkia Ura Vajgurore të marrë masa që në rastet e kryerjes së shërbimit të pastrimit nga të tretë nëpërmjet Sektorit të Shërbimeve të kryejë monitorimin dhe mbikqyrjen e shërbimit të pastrimit të dokumentuar me relacione mujore, ku të pasqyrohen punimet e kryera sipas zërave të situacionuara dhe të bëhet vlerësimi i tyre krahasuar me kushtet e kontratës.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Ura Vajgurore nuk është bërë depozitimi i lejeve zhvillimore në Arkivin Qendror Teknik, në kundërshtim me ligjin nr. 107/2014. date 31.07.2014 ”Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit ” i ndryshuar, të VKM nr.408 datë

13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit “i ndryshuar neni 70/12, pika 1.

12.1 Rekomandimi: Bashkia Ura Vajguore të marrë masa, që të bëjë depozitim e 7 lejeve zhvillimore të dhëna në vitin 2016 në Arkivin Qendror Teknik, në zbatim të ligjit nr. 107/2014. date 31.07.2014 ”Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit ” i ndryshuar.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Ura vajguore dhe 3 ish-Komunat Kutalli, Poshnje dhe Cukalat nuk është mbajtur libri inventar me të dhënat e aktiveve të trupëzuara me azhurnimet e përditësuara deri në momentin aktual, domosdoshmëri kjo për të patur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit, në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar, VKM nr.783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël" dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, Kap III pika 30.

13.1 Rekomandimi: Bashkia Ura Vajguore të marrë masa që nëpërmjet Drejtorisë së Financës të krijojë dhe të mbajë regjistrin e aktiveve, i cili të hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit, ku të përfshijnë: datën e hyrjes ose të marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritjen të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes deri në daljen e tij jashtë përdorimit.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Dosjet teknike të investimeve të cilat u audituan rezultuan me mangësi në dokumentacion, veprime këto në kundërshtim me UKM nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 4, paragrafi 4.

14.1 Rekomandimi: Bashkia Ura Vajguore, nëpërmjet Zyrës së Planifikimit të Territorit, të marr masa për plotësimin e dokumentacionit të dosjeve teknike të investimeve gjatë procesit të zbatimit të kontratave deri në dorëzimin e objektit.

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi: Për vitet 2012 deri 2016 nga Drejtorët dhe përgjegjëset e zyrës taksave dhe inspektorët e taksave në 3-ish komunat **Kutalli, Poshnje dhe Cukalat** edhe pse janë nxjerrë listat e debitorëve dhe janë dërguar në zyrën e financës për tu regjistruar si debitorë, nuk janë kryer rakordime ndërmjet Drejtorisë Financës dhe Drejtorisë Taksave, duke mos hapur analizat (partitarët), në kundërshtim me nenet 6 dhe 7 të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe pikën 3 të Udhëzimit Ministrisë Financave nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, rubrika “Dokumentimi i lëvizjeve të aktiveve”. Me kërkesën e grupit të auditimit të KLSH gjatë periudhës së auditimit, u nxorën dhe rakorduan të dhënat për periudhën nga viti 2012 deri më datën 31.12.2016, për taksat e papaguara; nga bizneset, taksa e tokës, qiraja e tokave të pandara, taksat e popullatës, etj, respektivisht për Bashkinë Ura-vajguore dhe 3 ish-komunat, aktualisht Njësitë Administrative, duke krijuar një të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Ura Vajguore në vlerën **109,704,741 lekë**.

15.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria e taksave të Bashkia Ura-Vajguore të merren masa për krijimin e regjistrimit elektronik dhe arkëtimin e vlerës prej **109,704,741 leke**, duke bërë njoftim vlerësimet tatimore, bazuar në nenin 70 pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar dhe konkretisht:

-**në vlerën 10,493,515 leke** si pasojë e mos pagimit në afat sipas parashikimeve në kontratat dypalëshe, për qiranë e tokave të pandara në vite në Bashkinë Ura - Vajgurore dhe 3 Njësitë Administrative, respektivisht, **Kutalli, Poshnje dhe Cukalat**.

-**në vlerën 25,028,561 leke**, nga mos pagesa e 249 bizneseve detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ku megjithëse janë dërguar bankave urdhrat e bllokimit në banka, nuk është bërë e mundur arkëtimi i tyre.

-**në vlerën 13,685,680 leke**, si pasojë e mos llogaritjes të taksave vendore për 9 subjekte të pajisura me lejë shfrytëzimi për aktivitetin e guroreve nga Ministria e Industrisë dhe Energjetikës (ish-MEI). (për 9 subjektet sipas listës trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit , njoftim vlerësimet tatimore të vlerësohen rast pas rasti nga ana e Drejtorisë Juridike të Bashkisë Ura Vajgurore, në lidhje me ankesat dërguara me shkresën nr. 1517, datë 06.6.2017 protokolluar në KLSH me nr. 259/14 datë 07.06.2017)

-**në vlerën 66,982,267 leke**, nga mos pagesa për taksën e tokës nga 4930 Fermerëve.

-**në vlerën 7,199,798 leke**, nga mos pagesa nga popullata të taksave për ndërtesat, tarifrat e pastrimit.

Pavarësisht kërkesave të mëparshme, duke i rikërkuar vazhdimisht dhe ndjekur rrugët e mëposhtme:

a. Tu ridërgohen Bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH", i ndryshuar.

b.Ti kërkohet Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit vendosja e barrës siguroese, (për mjetet) dhe Zyrës Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (për pasuritë) bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat tatimore në RSH " të ndryshuar.

c. Drejtoria e taksave për mos pagesën e taksave në afat të aplikojë dënim me gjobë për pagesat e vonuara, në masën 0,06% kamat vonesë për çdo ditë vonesë por jo më tepër se 365 ditë, bazuar në nenin 114 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr. 164/2014 datë 15.12.2014.

d-Edhe pas njoftimeve zyrtare në se Bizneset nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite nga ana e Bashkisë (Drejtoria e Taksave dhe Drejtoria Juridike), të merren masa administrative (llogaritje kamat vonesave) apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal pranë organit të Prokurorisë, siç përcaktohet në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008" Për Procedurat tatimore në RSH" ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 4.12.2014.

d -Drejtoria e taksave në Bashkinë Ura-Vajgurore dhe 3 Njësitë administrative, të listojnë në mënyrë elektronike abonentët familjarë debitorë gjithsejtë për vlerën **74,182,665 lekë**, respektivisht, taksa e tokës nga **4930 fermerë** në vlerën **66,982,867 lekë** dhe taksat e popullatës në vlerën **7,199,798 lekë**. Duke njoftuar tatimpaguesit familjarë me Njoftim vlerësimi tatimor edhe në median lokale, për të paguar detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak, nëpërmjet dërgimit të njoftim vlerësimi me anë të zyrës postare, sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile, për të gjitha llojet dhe shumën e taksave të papaguara, si taksën e tokës, banesave dhe tarifrat etj, siç përcaktohet në pikën 71, të UMF nr. 01, datë 15.01.2016 "Për zbatimin e buxhetit 2016".

Menjëherë

16. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Ura-Vajgurore dhe 3-ish Komunat Kutalli, Cukalat dhe Poshnje për periudhën 2009-2013 janë dhënë me qera 170 ha, toka bujqësore të pandara 228 qiramarrësve. Nga ish-Komunat dhe pas reformës territoriale dhe bashkimin me Bashkinë Ura-Vajgurore, në asnjë rast për dhënien me qera për tokat e pandara, nuk është bërë **kontrolli i respektimit të kushteve të kontratës**, në kundërshtim me Udhëzimin e KM nr. 1, datë 18.07.2012 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara", pika 5/d.

16.1 Rekomandimi: Bashkia Ura-Vajguore të marrë masa dhe të ngrejë një grup pune me pjesëmarrjen Drejtorisë Taksave, Drejtorisë Financës, Drejtorisë Bujqësisë dhe Tokave, Drejtorisë Juridike, Topograf, Njësitë Administrative, etj, me qëllim verifikimin e zbatimit të kushteve të përcaktuara në 228 kontratat e lidhura për sipërfaqen prej 170 ha, për dhënine me qera të tokave bujqësore në vite.

Njëherazi të verifikohet statusi juridik i tokave të dhëna me qera dhe rastet e zaptimit të tokës mbi sasinë e përcaktuar në kontratat dy paleshe duke zbatuar legjislacionin në fuqi.

Menjëherë

17. Gjetje nga auditimi: Pas kryerje së reformës administrative dhe kalimi i aktivitetit të bizneseve në Bashkinë e madhe Ura-Vajguore nga punonjësit e 3- ish Komunave, aktualisht Njësi administrative **Kutalli, Poshnjë dhe Cukalat**, po dhe lëvizjet e shpeshta në Drejtorinë e taksave të Bashkisë, punonjësit të cilët janë larguar apo janë emëruar të rinj, nuk kanë marrë apo dorëzuar detyrën me procesverbal, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 510, datë 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial".

17.1 Rekomandimi: Bashkia Ura-Vajguore të marrë masa që detyra dhe dokumentacioni përkatës, veçanërisht listat e bizneseve private të cilat nuk kanë paguar taksat vendore për 3 vitet 2012-2013-2014 deri në shkriren e tyre më datën 15.07.2015 të dorëzohet me procesverbal.

Menjëherë

18. Gjetje nga auditimi: Bashkia Ura-Vajguore për 2 vitet 2015-2016 nuk ka grumbulluar taksat dhe tarifave vendore, edhe pse ka mazhorancën e aksioneve në Ujësjiellës sh.a, Ura-Vajguore dhe për vitin 2016 kanë patur përfaqësues në Këshillin Administrativ të krijuar kohët e fundit, Ujësjiellës sh.a. Ura-Vajguore nuk është përcaktuar si agjent tatimor, për arkëtimin e taksave vendore së bashku me faturat e ujit të pijshëm, bazuar në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5 shkronja (ii), neni 7 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore" i ndryshuar, pikës 7.1 të UMF nr. 24, datë 02.09.2008 "Për Procedurat Tatimore", i ndryshuar, marrëveshje e cila do të rriste arkëtimin e taksave vendore dhe do rigjenerojë të ardhura për Bashkinë Ura-Vajguore.

18.1 Rekomandimi: Bashkia Ura-Vajguore të përgatisë aktmarrëveshjen me Ujësjiellës sh.a. Ura-Vajguore, për kryerjen nga ana e këtij të fundit të agjentit tatimor për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore të popullatës, së bashku me faturat ujit të pijshëm, marrëveshje e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak bazuar në legjislacionin në fuqi.

Menjëherë

19. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Ura-Vajguore nuk është vepruar, për të lidhur kontratë qiraje me subjektet private të cilat janë pajisur me leje minerare (për aktivitet shfrytëzim gurore) dhe leje koncesionare të miratuara nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë si dhe nga Ministria e Mjedisit, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullimore ku ushtrojnë aktivitetin e tyre për qëllime biznesi, në shkelje të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008 "Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor", i ndryshuar dhe VKM nr. 1374, datë 10.10. 2008 "Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullimor" i ndryshuar .

19.1 Rekomandimi: Bashkia Ura-Vajguore nëpërmjet strukturave të saj dhe zyra e administrimit të pyjeve e kullotave, të marrë masa për lidhjen e kontratave të qirasë me subjektet e pajisur me leje minerare për shfrytëzim gurore dhe të kërkojë arkëtimin e të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë dhe heqjen nga fondi pyjor, në zbatim të VKM 1353, datë 10.10.2008 "Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e

dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar dhe VKM nr. 1374, datë 10.10. 2008 “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor” i ndryshuar.

Menjëherë

20. Gjetje nga auditimi: Bashkia Ura Vajgurore nuk ka zbatuar të gjitha rekomandimet e lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm dërguar me shkresës nr. 371/6, datë 30.06.2014 për arkëtimin e vlerës **2,541,016 lekë**, konkretisht:

a. nuk është arkëtuar vlera 2,401,200 lekë ndaj 5 subjekteve gurore, të cilat nuk kanë shlyer detyrimet vendore para vitit 2014, përkatësisht: “A...” shpk 1,000,400 lekë, “R...” shpk 452,900 lekë, “R...P.” 493,900 lekë, “A...” shpk 249,000 lekë dhe subjektit E.B. 205,000 lekë.

b. nuk është arkëtuar vlera 139,816 lekë për masën disiplinore të vendosur “ndalesën e ¼ e pagës mujore për 4 muaj”, për M.B. 47,030 lekë, F.P. 47,030 lekë dhe V.J. 45,756 lekë.

20.1 Rekomandimi: Bashkia Ura-Vajgurore të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat ligjore për zbatimin e rekomandimeve të KLSH për arkëtimin e vlerës **2,541,016 lekë** (sipas pasqyrës të raportit përfundimtar të auditimit).

Menjëherë

B. MASA SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) -*Të drejtat e KLSH* dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga **Titullari i njësisë publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **12,191,045 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimeve të bankës të **Bashkisë Ura Vajgurore**, për 3 vitet 2014, 2015 dhe 2016, u konstatuan shkelje ligjore dëm ekonomik për vlerën **239,259 lekë** të përfituar nga subjekti “I.C...” shpk, sipas urdhër shpenzimit nr. 431, datë 5.9.2016, për “*Ndërtim i shkollës mesme Ura Vajgurore*”, për periudhën 2015”, pasi në preventivin dhe situacionin përfundimtar nr. 787/5, datë 28.12.2015, zëri “Makineri dhe Pajisje” subjekti i ka llogaritur me gjithë vlerën e tvsh, në mospërputhje me UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, nuk është ndarë veças vlera e “montimit” të pajisjeve pa tvsh dhe veças vlera e “pajisjeve” me gjithë vlerën e tvsh.

1.1.Rekomandimi: Bashkia Ura-Vajgurore të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **239,259 lekë** ndaj subjektit “I.C...” shpk.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i **Komunës Kutalli** u konstatuan shkelje me efekte financiar **dëm ekonomik** në vlerën **795,400 lekë**, konkretisht:

a. 402,000 lekë për subjektin “L...2...” shpk, sipas urdhër shpenzimit nr. 186, datë 7.7.2015, pasi është shpenzuar për sistemim të pikave të hedhjes së plehrave kur ky shërbim është kryer njëherë edhe 6 muaj më parë sipas urdhër shpenzimit nr. 296, datë 31.12.2014, nga ky njëjti subjekt.

b. vlera 70,800 lekë, nga financieri B.R. për blerje kancelari e shtypshkrime pa normativë ligjore, pa planifikim dhe në mënyrë të pajustificuar, sipas urdhër shpenzimit nr. 178, datë 4.7.2015.

c. vlera 290,000 lekë, përfituar **dieta të pa justifikuara** për periudhën qershor 2015, sipas urdhër shpenzimit nr. 175 dhe 176, datë 3.7.2015, në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjëset që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit”, nga 28 punonjës të administratës Kutalli, sipas listës në Projekt Raportin e Auditimit.

d. vlera 32,600 lekë përfituar tepër shpenzime celular për vitin 2014 dhe 2015 nga **Sh.V.** në kundërshtim me VKM nr. 864, datë 23.07.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celularë të personave juridikë, publikë”, pika 9, sipas urdhër shpenzimeve nr. 142, datë 15.6.2015, nr. 10, datë 19.01.2015, nr. 106, datë 16.06.2014, nr. 77, datë 16.05.2014, nr. 56, datë 17.04.2014, nr. 41, datë 24.03.2014, nr. 281, datë 26.12.2014, nr. 240, datë 20.11.2014, nr. 209, datë 28.10.2014 dhe nr. 157, datë 25.8.2014.

e. vlera 85,500 lekë nga preventivuesi **G.I.**, pasi në preventivin e objektit “*Ndërtim i fushës Sportive “kalceto” shkolla 9-vjeçare Drenovicë, Kutalli, për vitin 2014*” ka rritur artificialisht fondin limit, duke përfshirë edhe zërin “supervizion 74,250 lekë +kolaudim 11,250 lekë,” për punë të pakryer nga subjekti, pasi ky shërbim kryhet nga specialist tjerë të licencuar sipas kontratave përkatëse, në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

2.2. Rekomandimi: Bashkia Ura-Vajguore të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës **795,400 lekë**, përkatësisht:

-vlerën 402,000 lekë për subjektin “**L.2...**” shpk,

-vlerën 32,600 lekë për **Sh.V.**

-vlerën 85,500 lekë për **G.I.** dhe

-vlerën 290,000 lekë për 28 punonjësve të Komunës Kutalli (sipas listës Projekt Raportit).

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Ura-Vajguore rezultojnë të pa arkëtuara dhe të kontabilizuara 4 gjopa të IMTV të vendosura në vitin 2014 për vlerën **2,651,950 lekë**, përjashtuar 1 rast, sipas shkresës nr. 205/2, datë 28.4.2014.

3.1. Rekomandimi: Bashkia Ura-Vajguore të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës **2,651,950 lekë**, përkatësisht:

- vlerën **10.000 lekë** për K.B.

- vlerën **787,950 lekë** për D.Zh.

- vlerën **927,000 lekë** për A.D.

- vlerën **927,000 lekë** për V.D.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Ndërtim i fushës Sportive “kalceto, shkolla 9-vjeçare Drenovicë*”, Komuna Kutalli, për vitin 2014” nga auditimi rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **10,920 lekë dëm ekonomik**, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave të situacionit sipas punimeve të kryera në fakt. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 dhe 12 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimit KM nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 3, kontratën e sipërmarrjes së punimeve.

4.1. Rekomandimi: Bashkia Ura-Vajguore të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës **10,920 lekë lekë** ndaj subjekti “**L.2...& B...**” shpk.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Në objektin *“Rrethimi i fushës sportive të shkollës 9-vjeçare fshati Gorican Çirim”* komunës Kutalli, për vitin 2014”, nga auditimi rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **40,120 lekë dëm ekonomik**, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 dhe 12 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 3, kontratën e sipërmarrjes së punimeve.

5.1. Rekomandimi: Bashkia Ura-Vajguore të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës **40,120 lekë** pa t.v.sh ndaj subjekti *“B...”* shpk.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se subjekti *“T&T Beton”* shpk në objektin *“Sistemin rrethim oborri, ndërtim palestere, Shkolla e Bashkuar, lagjja 4 shtatori, 2014”*, ka përfituar në mënyrë të paligjshme vlerën **588,550 lekë dëm ekonomik** pa tvsh, pasi në fund të preventivit dhe situacionit përfundimtar subjekti ka përfshirë padrejtësisht 3% zbatim masash sigurie në kantier, kur ky zë është përfshirë në çdo zë punimi të preventivit dhe situacionit, sipas analizës së kostos tek shpenzimet e përgjithshme, veprim në kundërshtim me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualit teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike tyre” dhe me UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”.

6.1. Rekomandimi: Bashkia Ura-Vajguore të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës **588,550 lekë** ndaj subjekti *“T...B...”* shpk.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Në ish-komunat **Kutalli, Poshnje dhe Cukalat** janë kryer pagesa për shpërblimin e Këshilltarëve për çdo muaj mbi bazën e listë prezencave të pjesëmarrjes së këshilltarëve në mbledhje të hartuara nga Kryetarët e Këshillave të dërguara pranë Sektorit të Financës. Nga verifikimi i protokollit të mbajtur nga Sekretarët e Këshillave për çdo mbledhje të realizuara rezultoi se, prezenca e këshilltarëve në mbledhje për muajt përkatës, nuk përkon me listë prezencat e dorëzuara. Gjithashtu u konstatuan që jo në të gjithë muajt janë zhvilluar mbledhje si dhe ka patur mungesa të pjesëmarrjes në mbledhjet e zhvilluara të këshilltarëve të ndryshëm, të cilëve u është paguar shpërblimi padrejtësisht për këto muaj. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”i ndryshuar, Kreun VI, neni 29, pika 2; neni 31, pika 2 dhe pika 8, **me pasojë dëmin ekonomik në shumën 5,520,293 lekë**.

7.1. Rekomandimi: Bashkia Ura-Vajguore të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **5,520,293 lekë**, të përfituar padrejtësisht nga Këshilltarët për mospjesëmarrje në mbledhje të Këshillave, duke mos kryer punën e tyre, ku nga këto: këshilltarët e ish-Komunës **Kutalli** në shumën **1,995,095 lekë**, këshilltarët e ish-Komunës **Poshnje** në shumën **2,296,005 lekë**, këshilltarët e ish-Komunës **Cukalat** në shumën **1,229,193 lekë**, sipas shumave përkatëse të përlogaritura për çdo këshilltar të paraqitur në tabelën në pikën 5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Në objektin *“Rehabilitim, Ndrëhim, Gjelbërim i Shëtitores të Lagjes 18 “Tetori”*, Bashkia Ura Vajguore, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca më tepër në vlerë, në vlerën **1,997,259 lekë pa tvsh, duke shkaktuar dëm ekonomik**, si pasojë e situacionimit të punimeve fiktive të kryera në kontratën shtesë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimin e KM nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin e KM nr. 3, datë 15.02.2001 të

Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 3.2 dhe 3.3, kontratën për mbikëqyrjen e punimeve lidhur me Autoritetit Kontraktor Bashkia Ura Vajguore dhe mbikëqyrësit të punimeve **ing. E.Ç**, neni 4 dhe neni 6 pika 1, Udhëzimin e KM nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pika 8.1 dhe 8.3, Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pikat 3.

8.1.Rekomandimi: Bashkia Ura-Vajguore të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **1,997,259 lekë pa tvsh** nga BOE “T.B...” Shpk dhe “G... C...” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 565/12 prot., datë 11.09.2015 me objekt “*Rehabilitim, Ndrichim, Gjelberim i Shetitores të Lagjes “18 Tetori”*”.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Sistemimi, Rrethimi i Oborrit, Ndërtim i Palestrës dhe Fushës Sportive për Shkollën e Mesme të Bashkuar*”, Bashkia Ura Vajguore, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca më tepër në vlerë **347,294 lekë pa tvsh me dëm ekonomik**, për punime të pakryera në fakt. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 3.2 dhe 3.3, kontratën për mbikëqyrjen e punimeve lidhur me Autoritetit Kontraktor Bashkia Ura Vajguore dhe **mbikëqyrësit të punimeve ing. Tomorr Spahiu**, neni 4 dhe neni 6 pika 1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pika 8.1 dhe 8.3, Udhëzimin e KM nr. 2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pikat 3.

9.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Ura Vajguore të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **347,294 lekë pa tvsh** nga BOE “T...B...” Shpk dhe “B...” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 551/3 prot., datë 02.12.2014 me objekt “*Sistemimi, Rrethimi i Oborrit, Ndërtim i Palestrës dhe Fushës Sportive për Shkollën e Mesme të Bashkuar*”, Bashkia Ura Vajguore, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

B/1. SHPENZIME ME EFEKT NEGATIV NË BUXHETIN E BASHKISË:

Nga auditimi rezultoi se në 6 raste është konstatuar mos efektivitet i fondeve publike më impakt negativ në buxhetin e Bashkisë Ura-Vajguore në vlerën **8,522,605 lekë**, të cilat në mënyrë të detajuar, **paraqiten si më poshtë:**

1. Gjetje nga auditimi: Në prokurimin publik me objekt “*Rikonstruksioni i rrugës shkolla Ciflik-Fshati Arrëz*” KVO-së me përzgjedhjen e ofertës fituese në kundërshtim me nenet 20, 23, 46, 53, 54 të ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, kreu VII i VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ka sjell efekt financiar negativ për përdorim me mos eficence të buxhetit të NjQV ish-Komuna Poshnje, në vlerën **2,369,570 lekë**.

1.1 Rekomandimi: Bashkia Ura-Vajguore të marrë masat të analizoj me grup pune mungesën e efikasitetit të fondeve publike në vlerën **2,369,570 lekë**, për procedurën me objekt “*Rikonstruksioni i rrugës shkolla Ciflik-Fshati Arrëz*” duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Në prokurimin publik me objekt “*Punime rikonstruksioni në rrugë*” KVO-së me përzgjedhjen e ofertës fituese në kundërshtim me nenet 20, 23, 46, 53,

54 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar , kreu VII i VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ka sjell efekt financiar negativ për përdorim me mos efience të buxhetit të NjQV, në vlerën **1,141,886 lekë**.

2.1 Rekomandimi: Bashkia Ura-Vajgurore të marrë masat të analizoj me grup pune mungesën e efijencës të fondeve publike në vlerën **1,141,886 lekë**, për procedurën me objekt “Rikonstruksioni i rrugës shkolla Ciflik-Fshati Arrëz” duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për administrimin e karburantit, u konstatua se për periudhën qershor–korrik 2015, paraqiten shpenzime të tepërta dhe të pajustificuara, për vlerën **1,341,810 lekë mosefektivitet në përdorimin e fondeve publike**, pasi karburanti në adresë të automjeteve të bashkisë (*Benzi, Foristrada, Kamioncina, Skanja dhe Skrepi*) nuk është i justifikuar, sepse nuk rakordon sasia e furnizuar me kilometrat e përshkuara sipas normativave ligjore, nuk përputhen kilometrat e përshkruara me tabelën e miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Transportit, madje janë pasqyruar kilometra të ndryshme në linja të njëjta udhëtimi, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10279, datë 08.07.2010 “Mbi menaxhimin financiar e kontrollit”, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

3.1 Rekomandimi: Bashkia Ura-Vajgurore të marrë masat të analizoj me grup pune të veçantë duke nxjerrë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me efektivitet, ekonomikitet dhe efience të fondeve publike për shpenzime karburanti me efekte negative në përdorimin e fondeve publike në vlerën **1,341,810 lekë** duke vënë theksin në rritjen e vlerës së shtuar nga përdorimi i fondeve publike në shërbim të komunitetit.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimeve të bankës të Bashkisë Ura-Vajgurore për vitin 2014, 2015 dhe 2016, u konstatuan shkelje ligjore për vlerën **2,438,339 lekë mos efektivitet të fondeve publike**, konkretisht:

- vlera **318,960 lekë** për shpenzime pritje përcjellje (dreka) në 3 raste, në kundërshtim me VKM nr. 243, datë 15.05.1995 “Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja” të ndryshuar me VKM nr. 258, datë 3.6.1999, sipas urdhër shpenzimeve nr. 471, datë 10.12.2014, nr. 183, datë 14.4.2016 dhe nr. 756, datë 27.12.2016,
- vlera **192,000 lekë** për shpenzime të pa justifikuara dhe pa normativë ligjore, për blerje goma për mjetin fadromë, sipas urdhër shpenzimit nr. 744, datë 22.12.2016,
- vlera **250,659 lekë**, për shpenzime të kryera mbi bazën e një dokumentacioni të parregullt dhe të pa justifikuar, pasi shpenzimi është krye më parë dhe fletëdaljet nr. 265 dhe 266 datë 30.6.2015 janë kontabilizuar pas mbylljes të veprimeve me ditarin e magazinës, në të cilin ka korrigjime (muajin qershor 2015), sipas urdhër shpenzimit nr. 272, datë 29.6.2015, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e Aktiviteteve ne Njësinë e Sektorit Publik” neni 36 dhe shkresën e MF nr. 47, datë 30.6.2015 pika 2.
- vlera **1,676,720 lekë** për tejkalim të limitit ligjor 25% të shërbimeve kapitale në vit, për mjetet e bashkisë Volkswagen Tuareg dhe Fadromën, sipas urdhër shpenzimit nr. 92, datë 3.3.2016 dhe nr. 433, datë 13.11.2014.

4.1 Rekomandimi: Bashkia Ura-Vajgurore të marrë masa:

- për shmangien e shpenzimeve për pritje e përcjellje për komunitetin vendas, pasi mungon baza ligjore,
- për respektimin e limitit ligjor 25% të shërbimeve kapitale në vit për automjetet e saj,
- për kryerjen e shpenzimeve për riparime, goma dhe pjesë këmbimi mbi bazën e normativave ligjore dhe një dokumentacioni të rregull.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimeve të bankës të Komunës Kutalli për vitin 2013, 2014 dhe 2015, u konstatuan shkelje ligjore për vlerën **1,596,000 lekë mos efektivitet të fondeve publike**, konkretisht:

-vlera 658,200 lekë, sipas urdhër shpenzimit nr. 187, datë 7.7.2015, për pastrim kanali kullues Drenovicë, Goriçan, Samaticë dhe Pobrat, shpenzim i kryer me një dokumentacion me mangësi dhe të pajustificuar.

-vlera 216,000 lekë, shpenzim i përsëritur brenda 5 muajve i paefektivitet, sipas urdhër shpenzimit nr. 283, datë 26.12.2014, dhe nr. 159, datë 23.6.2015.

-vlera 360,000 lekë, për blerje goma brenda 9 muajve për mjetin Wolksvagen Tuareg, në mënyrë të pa justifikuar dhe pa normativa ligjore, sipas urdhër shpenzimit nr. 118, datë 20.05.2015, nr. 234, datë 19.11.2014 dhe nr. 174, datë 16.09.2014.

-vlera 577,799 leke, sipas urdhër shpenzimit nr. 169, datë 29.6.2015 është shpenzuar për rikonstrukcion i rrugëve te brendshme, rezulton se në dokumentacionin nuk përcaktohen adresat e rrugëve që i nënshtrohen rikonstrukcionit.

5.1 Rekomandimi: Bashkia Ura-Vajgurore të marrë masat të analizoj me grup pune të veçantë duke nxjerr shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me efektivitet, ekonomikitet dhe eficence të fondeve publike për procedurën e prokurimit me efekte negative në përdorimin e fondeve publike në vlerën **1,596,000 lekë** duke vënë theksin në rritjen e vlerës së shtuar nga përdorimi i fondeve publike në shërbim të komunitetit.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Për periudhen 2013-2015 në **ish-Komunën Cukalat** janë kryer shpenzime për transportin e nxënësve të dalluar në 2 raste në shumën 239,000 lekë në qytete të ndryshme të Shqipërisë, ku nuk përcaktohet as qëllimi i udhëtimit dhe as numëri i nxënësve të transportuar, udhëtime këto që duhet të përballoheshin nga institucionet arsimore (DAR) dhe jo nga Bashkia në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar pika VII, me pasojë efektin financiar negativ për buxhetin e Bashkisë në shumën **239,000 lekë**.

6.1 Rekomandimi: Bashkia Ura Vajgurore të marrë masa që në asnjë rast të mos kryejë shpenzime në lidhje me udhëtimin dhe akomodimin e nxënësve të shkollave në aktivitete si eskursionet, ekspedita apo shpenzime të tjera të karakterit didaktik e mësimor, pasi nuk është pjesë e funksioneve të saj, përveç rikonstrukcionit dhe mirëmbajtjes të ambienteve të institucioneve arsimore për krijimin e kushteve dhe mbarvajtjen e mësimdhënies në kuadër të funksioneve të përbashkëta të përcaktuara në ligjin organik të funksionimit të njësive vendore.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE:

C1. Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil.

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së* të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të nenit 58, “*Ilojet e masave disiplinore*” të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe nenin 64 shkronjat (g, k). të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” **i rekomandojmë** Kryetarit së Bashkisë Ura-Vajgurore, që ti kërkojë Komisionit disiplinor të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore **25 punonjësve** të mëposhtëm:

“Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj, për 6 punonjësit e mëposhtëm:

1. M.B. me detyrë përgjegjëse e financës Bashkia Ura Vajgurore.

Për shkeljet e mëposhtme:

- Moszbatimin e detyrave të rekomanduara më parë.
- Shkelje në fushën financiare në vlerën 310,498 lekë dëm ekonomik dhe 1,676,720 lekë mos efektivitet në përdorimin e fondeve publike, për vitin 2014-2016.
- Për pa saktësi në mbylljen e bilancit 2015 në zërin amortizimi vjetor.
- Në nxjerrjet jashtë përdorimit të 8 automjeteve të Bashkisë Ura Vajgurore, pasi ato janë shkarkuar nga kontabiliteti pa përfunduar procedura e asgjësimit tyre dhe pa u kryer ç’regjistrimi në organet përkatuese.
- Lejimin e pagesës së qirasë të 2 mjeteve private me kosto të lartë, për transportin e mbeturinave urbane për vlerën 151,500 leke/muaj dhe për lagjen e rrugëve me vlerën 227,000 lekë/muaj, sipas kontratës nr. 175/8, datë 21.05.2014 dhe nr. 18/6, datë 14.7.2014, çka me këtë vlerë mund të bliheshin mjete të reja brenda 1 viti.

2. M.D. me detyrë supervisor i pastrimit në Drejtorinë e Shërbimeve dhe K/inspektor i INUV për vitin 2014 në Bashkinë Ura Vajgurore.

Për shkeljet e mëposhtme:

- Mos dokumentimin dhe mos mbajtjen e procesverbaleve ditore për mbikëqyrjen e shërbimit të pastrimit, për punën e pakryer ose pa cilësi të shoqërisë sipërmarrëse të pastrimit. Për mos lënien e gjurmëve në situacionet e firmës të pastrimit, për zbritjen e zërit “fshirje rrugësh” për sipërfaqet e zëna (brenda vijave të verdha) nga parkimi i automjeteve të qytetarëve, për sipërfaqet e zëna të rrugëve, trotuareve dhe shesheve nga rikonstruksioni i tyre me tenderim. Për mos zbritjen e zërit “lagje rrugë, trotuare dhe sheshe” për ditët me shi si dhe mos aplikim penalitete ndaj firmës sipërmarrëse. Veprime në kundërshtim me rregulloren e brendshme të bashkisë dhe me kontratën nr. 1176/12, datë 01.09.2016.
- Mos marrjen e sanksione për 12 ndërtime të paligjshme për periudhën e auditimit, pasi vendimet e pezullimit nuk janë shoqëruar me vendime prishje dhe gjoba si dhe kallëzime penale, në kundërshtim me nenin 75 të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën” dhe me nenin 5 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për Inspektimin e ndërtimit” i ndryshuar me ligjin nr. 183/2014 neni 5, neni 12 dhe 13/ç, si dhe me nenin 15/a të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” Kreu III Sanksionet, ndryshuar me ligjin nr. 9794, datë 23.7.2007 etj., nenit 81 “Sanksionet”, të ligjit Urbanistikës dhe pikës 8, të VKM nr 862, datë 05.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga INUKV.
- Mos vjeljen e 4 gjobave për vlerën 2,651,950 lekë të vendosura nga vetë INUV, për vitin 2014, si dhe për mos dërgimin e shkresës në zyrën e financës për kontabilizimin e tyre.

3. R.P. me detyrë përgjegjëse e shërbimeve Bashkia Ura Vajgurore.

Për shkeljet e mëposhtme:

- Mos administrimin e karburantit dhe mos rakordimin e tij, çka ka krijuar vlerën 1,341,810 lekë mos efektivitet të fondeve publike.
- Për mangësi në kontrollin dhe mbikëqyrjen e shërbimit të pastrimit, për mos kryerjen e një analizë ekonomike-financiare për leverdishmërinë ekonomike të shërbimit pastrimit, me sipërmarrje private apo nën administrimin e bashkisë, për efekt të disiplinimit të shpenzimeve dhe përdorimi i tyre me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet, çka ka bërë që administrimi i këtij shërbimi të mos përqendrohet në një formë organizimi, por të jetë me lëvizje në periudhën e auditimit 2013-2016.

- Për shkelje në marrjen me qira të 2 automjeteve private në vitin 2014, për shërbimin e pastrimit, çka ka krijuar kosto të lartë për vlerën 4,542,000 lekë.

-Në nxjerrjet jashtë përdorimit të 8 automjeteve të Bashkisë Ura Vajgurore si komisionere, pasi mjetet nuk janë asgjësuar dhe administruar në magazinë si skrap ose pjesë këmbimi, por ruhen në parkimin e bashkisë të pa çmontuara dhe të pa çregjistruara targat pranë NSHTRR Berat, pra nuk kanë përfunduar procedurat e asgjësimit tyre.

-Marrjen me qira të 2 mjeteve private me kosto të lartë, për transportin e mbeturinave urbane për vlerën 151,500 leke/muaj dhe për lagjen e rrugëve me vlerën 227,000 lekë/muaj, sipas kontratës nr. 175/8, datë 21.05.2014 dhe nr. 18/6, datë 14.7.2014, çka me këtë vlerë mund të bliheshin mjete të reja brenda 1 vitit.

4. B.R. me detyrë përgjegjëse e financës i ish-Komunës Kutalli.

Për shkeljet e mëposhtme:

-Për shkelje në fushën financiare në vlerën 795, 400 lekë dëm ekonomik dhe 1,234,200 lekë mos efektivitet në përdorimin e fondeve publike, për vitin 2013-2015.

-Për shkelje teknike në 3 procedurat e prokurimeve publike, në cilësinë e anëtarit të njësisë të prokurimit, konkretisht: “Ndërtim i fushës Sportive “kalceto” shkolla 9-vjeçare Drenovicë, Komuna Kutalli, për vitin 2014”, “Rikonstruksion rruga e plehrave të komunës Kutalli, për vitin 2014” dhe “Rikonstruksion pjesor i rrugëve Protoduar, Kutalli, Gorican-, Komuna Kutalli, për vitin 2014”.

5. D.L. në cilësinë e anëtares të njësisë të prokurimit për shkelje dhe mangësi në 3 procedura të prokurimit publik.

6. V.J. në cilësinë e anëtares të KVO për shkelje dhe mangësi në 3 procedura të prokurimit publik.

C/2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen sipas Kodit Punës.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të kontratës individuale të punës, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” për 19 punonjësit e mëposhtëm:**

1. B.I. me detyrë ish-Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore në Ish-Komunën Poshnje, në cilësinë e e anëtarit të KPVV, aktualisht specialist në drejtorinë e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Ura Vajgurore.

2. I.S. me detyrë ish-Përgjegjës Finance në ish-Komunën Cukalat në cilësinë e kryetarit të KPVV, aktualisht arshivist-arkëtar në NJA Cukalat.

- Për mangësitë e parregullsitë e konstatuara në procedurat e blerjeve me vlera të vogla në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Kreu i VI pikës 2/a, me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin rregullave të prokurimit publik” neni 40 Urdhrin MF nr. 33 datë 11.07.2013 dhe nr. 57 datë 12.06.2014 “Për Gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë” tabela1/3 dhe UMF nr. 30 datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik” pika 37, 42,43 dhe 44, ku mungojnë kërkesat për argumentim të nevojës së blerjes të mallit apo shërbimit dhe argumentimi i fondit limit, në disa raste nuk është bërë i plotë objekti prokurimit si dhe nuk është bërë shkarkimi nga sistemi elektronik i menysë së mesazheve mbi klasifikimin e ri të procedurës, nuk ka paraqitje nga OE fitues të ekstraktit të QKR dhe të

dokumenteve për plotësimin e detyrimeve të kërkuara në kriteret e kualifikimit. Për blerjet e mallrave dhe shërbimeve nuk ka akt-marrje në dorëzim të mallit apo të shërbimit të kryer.

3. N.T. me detyrë ish-Përgjegjës i Sektorit të Urbanistikës, në cilësinë e anëtarit të komisionit të emergjencës aktualisht në specialist në Drejtorinë e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Ura Vajgurore.

- Në 1 rast të kryerjes së shpenzimeve në formën e blerjes dhe konsumit të karburantit të vënë në dispozicion të automjeteve të rënda të firmës “Sh...”shpk për rehabilitimin e zonave të fshatrave Hing, Gajde dhe Koçe nga përmytjet nga komisioni i krijuar i emergjencës nuk është mbajtur dokumentacioni teknik e ligjor që vërteton punimet e kryera si, procesverbale të monitorimit të punimeve të kryera të emëtuara sipas zonës së shtrirjes, orët e punuara, volumet e kryera, data në të cilët janë bërë punimet, kontrata e lidhur me poseduesin e automjetit eskavator Tip Benat, përlllogaritja e karburantit të përdorur në fakt etj. në kundërshtim me pikën pika 37,42,43 dhe 44 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”.

4. R.Sh. me funksion Drejtore e zyrës taksave Bashkia Ura Vajgurore.

5. S.D. me funksion inspektore e taksave, për periudhën 13.08.2007 e ne vazhdim

6. A.Ç. me funksion inspektor i taksave per periudhen 13.10.2015 e ne vazhdim

Për mos marrjen e masave të nevojshme për arkëtimin e taksave vendore dhe pavarësisht punën që është bërë për arkëtimin e debitorëve, ende Bashkia Ura-Vajgurore së bashku me 3 Njësitë Administrative Kutalli, Poshnjë dhe Cukalat deri më datën 30.04.2017 ka debitorë për tarifatat dhe taksat vendore pa u likuiduar në vlerën **109,704,741** lekë, *respektivisht*; 249 biznese nuk kanë paguar taksat vendore në vlerën 25,028,561 lekë, dhe 4930 Fermerë nuk kanë paguar taksën e tokës për vlerën 66,982,867 lekë,

Ndërsa vetë **Bashkinë Ura-Vajgurore** më datën 30.04.2017 ka debitorë në vlerën 31,496,509 lekë, nga të cilat; 19 biznese në vlerën 2,847,233 lekë, 639 Fermerë nuk kanë paguar taksën e tokës bujqësore në vlerën 5,567,597 lekë dhe debitorët e taksës ndërtesave, taksës pastrimit në vlerën 7,199,798 lekë, në kundërshtim me udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”,

7. E.H. me funksion Administrator i Njësisë Kutalli

8. F.K. me funksion specialiste e taksave në Njësinë administrative Kutalli

9. L.C. me funksion inspektor i taksave për periudhën nga data 01.03.2013 e ne vazhdim.

Për mos marrjen e detyrës me proces verbal dhe pavarësisht punën që është bërë për arkëtimin e debitorëve, ende Njësia Administrative **Kutalli** deri më datën 30.04.2017 ka debitorë për tarifatat dhe taksat vendore pa u likuiduar në vlerën **35,142,540** lekë, ose rreth 30% të totalit të debitorëve, *respektivisht*; 77 biznese nuk kanë paguar taksat vendore në vlerën 4,895,140 lekë, 1874 Fermerë nuk kanë paguar taksën e tokës për vlerën 19,788,208 lekë, 202 qiramarrës për 51 ha toka të pandara me qira nuk kanë paguar detyrimet sipas kontratave të lidhura ndërmjet palëve për shumën prej 10,459,193 lekë, nga e cila vlera e qerasë 738,684 lekë dhe kamat vonesa në shumën 9,720,508 lekë , në kundërshtim me kushtet e caktuara në kontratat dypalëshe dhe pikën 71, të udhëzimit plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”.

10. P.S. me funksion Administrator i Njësisë Poshnjë, në cilësinë e kryetarit të komisionit të emergjencës dhe të Administratorit të NJA.

11. F.K. me funksion specialiste e taksave në Njësinë Administrative Poshnjë

Për mos marrjen e detyrës me proces verbal dhe pavarësisht punën që është bërë për arkëtimin e debitorëve, ende Njësia Administrative **Poshnjë** deri më datën 30.04.2017 ka debitorë për tarifatat dhe taksat vendore pa u likuiduar në vlerën **32,807,948** lekë, ose rreth 30% të totalit të debitorëve, *respektivisht*; 11 biznese nuk kanë paguar taksat vendore në vlerën 786,172 lekë, dhe 1768 Fermerë nuk kanë paguar taksën e tokës për vlerën 32,021,776 lekë, në kundërshtim me udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”.

12. Q.Z. me funksion Administrator i Njesisë Cukalat

13. L.H. me funksion specialist i taksave në njësinë Cukalat.

Për mos marrjen e detyrës me proces verbal dhe pavarësisht punën që është bërë për arkëtimin e debitorëve, ende Njësia Administrative **Cukalat** deri më datën 30.04.2017 ka debitorë për tarifatat dhe taksat vendore pa u likuiduar në vlerën **10,257,745** lekë, ose rreth 10% të totalit të debitorëve, *respektivisht*; 8 biznese nuk kanë paguar taksat vendore në vlerën 618,136 lekë, dhe 689 Fermerë nuk kanë paguar taksën e tokës për vlerën 9,605,286 lekë, në kundërshtim me udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”.

14. B.B. në cilësinë e anëtares të KVO për shkelje dhe mangësi në 2 procedura të prokurimit publik.

15. E.S. në cilësinë e anëtares të njësisë të prokurimit për shkelje dhe mangësi në 6 procedura të prokurimit publik.

16. A.P. në cilësinë e anëtarit të njësisë të prokurimit për shkelje dhe mangësi në 6 procedura të prokurimit publik.

17. M.B. në cilësinë e anëtarit të njësisë të prokurimit për shkelje dhe mangësi në 1 procedurë të prokurimit publik.

18. Q.N. në cilësinë e anëtarit të njësisë të prokurimit për shkelje dhe mangësi në 1 procedurë të prokurimit publik.

19. A.Gj. në cilësinë e anëtarit të njësisë të prokurimit për shkelje dhe mangësi në 1 procedurë të prokurimit publik.

C.3 Për punonjësit e larguar nga detyra dhe që nuk kanë adresim institucional:

Për **15 punonjësit** e larguar që nuk kanë marrëdhënie pune me Bashkinë Ura-Vajgurore dhe që atakohen me raportin përfundimtar të auditimit, propozimi i masave disiplinore quhet i ezauruar, konkretisht:

1. M.L. m funksion ish-Kryetarit të ish-Komunës Poshnje,
2. S.O. m funksion ish-kryetar i bashkisë Ura Vajgurore, larguar nga zgjedhjet vendore
3. Q.M., me detyrë ish-Përgjegjës i Sektorit të Finances në ish-Komunën Poshnje.
4. H.L. m funksion ish-Kryeinspektor Ndërtimi në ish-Komunën Poshnje.
5. D.D. m funksion ish-Specialist në Sektorin e Shërbimeve, në ish-Komunën Poshnje.
6. S.H. m funksion ish-Polic në ish-Komunën Poshnje.
7. A.H. m funksion ish-Përgjegjës i Sektorit të Ardhurave në ish-Komunën Poshnje.
8. Q.B. m funksion ish-magaznier në ish-Komunën Poshnje.
9. R.B. m funksion ish-Kryetares së Këshillit Poshnje.
10. J.Z. m funksion ish-Kryetarit të ish-Komunës Cukalat.
11. E.S. m funksion Inspektor i Përkrahjes Sociale në ish-Komunën Cukalat.
12. E.M. m funksion Inspektor Bujqësisë e Urbanistikës në ish-Komunën Cukalat.
13. N.S. m funksion ish-Kryetarit të Këshillit Cukalat.
14. F.A. m funksion ish-Kryetarit të Këshillit Kutalli.
15. N.Xh. m funksion ish-Drejtores e taksave për periudhën nga viti 2007 deri më 31.07.2015.

D. MASA ADMINISTRATIVE:

D.1. Për Agjencinë e Prokurimit Publik

Bazuar në germën “ç” të nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 7 pika 2, 3/a ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” i rekomandojmë Agjencisë së Prokurimit Publik, që në zbatim të nenit 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe Kreu X i VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar të vlerësojë dhe vendosë masa në raport me shkeljet e konstatuara për **10 punonjësit si më poshtë:**

1.1 Të vlerësoj dhe të marrë masa ndaj Titullarit të Autoritetit Kontraktor të ish-komunës Kutalli Sh.V.

-Për shpalljen fitues të njëjtit OE “Balliu” shpk, në 4 procedura të prokurimit publik në vitin 2014, duke shmangur konkurrencën e operatorëve ekonomik dhe në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të kualifikimit, si dhe mos anulimin për 1 rast të procedurës të prokurimit, përkatësisht:

- Në procedurën “Rrethimi i fushës sportive të shkollës 9-vjeçare fshati Gorican Çlirim komunës Kutalli, për vitin 2014” me fond limit 956,919 lekë pa tvsh.
- Në procedurën “Ndërtim i fushës Sportive “kalceto” shkolla 9-vjeçare Drenovicë, Komuna Kutalli, për vitin 2014” me fond limit 2,071,468 lekë pa tvsh,
- Në procedurën “Rikonstruksion pjesor i rrugëve Protoduar, Kutalli, Gorican-, Komuna Kutalli, për vitin 2014” me fond limit 1,615,207 lekë pa tvsh,
- Në procedurën “Rikonstruksion rruga e plehrave të komunës Kutalli, për vitin 2014” me fond limit 1,448,503 lekë pa tvsh, pasi ka kualifikuar dhe shpallur fitues në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të kualifikimit OE fitues “B...” shpk, për rrjedhojë tenderi duhej anuluar.

1.2 Të vlerësoj dhe të marrë masa ndaj anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të ish-komunës Kutalli, konkretisht:

- 1. T.C.** në cilësinë e Kryetar i KVO;
- 2. B.Z.** në cilësinë e anëtarit të KVO;
- 3. G.I.** në cilësinë e anëtarit të KVO;

Për shkeljet e mëposhtme:

a. Në procedurën kërkesë me propozim të objektit “*Ndërtim i fushës Sportive “kalceto”* shkolla 9-vjeçare Drenovicë, Komuna Kutalli, për vitin 2014” me fond limit 2,071,468 lekë pa tvsh, pasi ka kualifikuar dhe shpallur fitues në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të kualifikimit OE fitues “L.2...” shpk dhe “B...” shpk, konkretisht:

- vërtetimi i OSHE për energjinë elektrike është lëshuar 11 ditë pas datës së tenderit,
- subjekti “L.2...” shpk është angazhuar me mjete dhe makineri për të njëjtën periudhë (tetor 2014) në objekte tjera si “*ndërtimin e banjës së komunës*”,
- subjekti ka mangësi në listë pagesat, pasi mungon ajo e muajit Gusht 2014.

b. Në procedurën kërkesë me propozim të objektit “*Rikonstruksion pjesor i rrugëve Protoduar, Kutalli, Gorican-, Komuna Kutalli, për vitin 2014*” me fond limit 1,615,207 lekë pa tvsh, pasi në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të DST, mungesës të fuqisë punëtore dhe angazhimit të njëjtave makineri në kontrata tjera, të angazhuara në dy objekte të ndryshme, KVO nuk duhej të shpallte kualifikonte dhe shpallte fitues OE “B...” shpk në një nga procedurat e sipër trajtuara, pasi janë zhvilluar në të njëjtën ditë, veprim në kundërshtim me pikën 2/3 “kapaciteti teknik” pika 2/a dhe 5, me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu V, pika 4, “Hapja e vlerësimi i ofertave”, pika “ç”.

c. Në procedurën kërkesë me propozim të objektit **“Rikonstruksion rruga e plehrave të komunës Kutalli, për vitin 2014”** me fond limit 1,448,503 lekë pa tvsh, pasi ka kualifikuar dhe shpallur fitues në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të kualifikimit OE fitues “B...” shpk, për rrjedhojë tenderi duhej anuluar, konkretisht:

-subjekti nuk ka kryer pagesën e energjisë elektrike deri në 28 ditë para hapjes së tenderit, sipas vërtetimit nr. 82, datë 22.10.2014 të OSHE Berat,

-subjekti nuk disponon certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin për mjetin BR...B, pasi ka skaduar afati i tyre me datë 21.11.2014, në kundërshtim me pikën 2/3 “kapaciteti teknik” pika 3.

-subjekti është angazhuar me mjete dhe makineri për të njëjtën periudhë në objektin “Rikonstruksion rruga lidhëse nacionale-komuna Kutalli sipas kontratës datë 15.12.2014.

2.1 Të vlerësoj dhe të marrë masa ndaj Titullarit të Autoritetit Kontraktor të ish-komunës Poshnje M.L.

2.2 Të vlerësoj dhe të marrë masa ndaj anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të ish-komunës Poshnje, konkretisht:

1. N.T. në cilësinë e Kryetarit të KVO-së;

2. D.D. në cilësinë e anëtarit të KVO-së;

3. P.S. në cilësinë e anëtarit të KVO-së;

4. Q.B. në cilësinë e anëtarit të KVO-së;

5. D.L. në cilësinë e anëtarit të KVO-së.

Për procedurën e prokurimit publik me objekt: **“Rikonstruksioni i rrugës shkolla Ciflik-Fshati Arrëz”, Komuna Poshnje:**

Nga auditimi në sistem elektronik të procedurës së vlerësimit dhe dokumentacionit ligjor të paraqitur nga OE pjesmarrës, rezulton:

Arsyet e skualifikimit të OE “S...” se nuk hapet në sistem vërtetimi bankar, të ndodhur përpara faktit se është oferta ekonomike e favorshme dhe nuk do të sillte deformim të ofertës në përmbushje të detyrimeve të nenit 53 dhe 54, të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” përfshihen te devijimet e vogla dhe KVO, duhet ti kishte kërkuar OE plotësimin e këtij dokumentacioni, pasi mos hapja e dokumentit vjen nga arsye teknike të sistemit dhe jo për faj të operatorit ekonomik konkurrues.

Për sa më sipër, Vlerësimi i AK-së është në kundërshtim me nenet 20, 46, 53, 54 të ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, kreu V i VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pasi ka skualifikuar ofertues të cilët plotësojnë kriteret për kualifikim me devijime të vogla të pranuar nga ligji duke shkaktuar efekt financiar negativ për ish-komunën Poshnje në vlerën 2,369,570 lekë.

D/2. Për Ministrinë e Zhvillimit Urban. (Heqjen e licencës profesionale).

Mbështetur në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, VKM nr. 759, datë 12.11.2014 “Për Licencimin Profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të ndërtimit” dhe në nenet 13, 25 dhe pika 1/a, 1/e, e nenit 41, Kreu VI-të, “Sanksione dhe Dispozita kalimtare”, të “Rregullore për Kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe subjekte juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të ndërtimit”, për shkelje të ligjshmërisë në zbatimin e punimeve, në fushën e ndërtimit, **i rekomandojmë** Komisionit të Licencave, pranë Ministrisë të Zhvillimit Urban:

-Heqjen e licencës profesionale E.Ç. nën cilësinë e përfaqësueses ligjore të firmës “A. E...” Shpk, (OE mbikëqyrës të punimeve me të cilin është lidhur kontrata për mbikëqyrjen e punimeve);

Lidhur me dëmin ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit dhe njësisë së qeverisjes vendore si pasojë e situacionimit të punimeve fiktive gjatë zbatimit të kontratës për investime në objektin:

- **“Rehabilitim, Ndriçim, Gjelbërim i Shëtitores të Lagjes “18 Tetori”**, Bashkia Ura Vajguore, ku nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit rezultojnë diferenca **në vlerën 1,997,259 lekë pa tvsh si pasojë e situacionimit të punimeve fiktive të kryera në kontratën shtesë**. Më konkretisht si më poshtë:

Për ndjekjen e zbatimit të kontratës është caktuar sipas kontratës së shërbimit nr. 746/8 prot., datë 04.12.2015 subjekti “A.E...” Shpk, i cili përfaqësohet nga administratori E.Ç. i quajtur si “Mbikëqyrësi”. Shoqëria “A.E...” Shpk me nr. Licence MK 1476/6 datë 30.06.2015 “Për mbikëqyrje dhe kolaudim punimesh ndërtimi”. Vlera e kontratës është 750,000 lekë pa tvsh ose 900,000 lekë me tvsh. Afati i kryerjes së shërbimit për mbikëqyrjen e punimeve është afati i zbatimit të kontratës së sipërmarrjes.

Nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit rezultojnë diferenca më tepër në vlerë **1,997,259 lekë pa tvsh** duke shkaktuar dëm ekonomik, si pasojë e situacionimit të punimeve fiktive, mangësi në dokumentacion si dhe problematikat si më poshtë:

I. Mangësi në dokumentacion:

- Mungon pasqyra e realizimit të punimeve sipas formatit tip;
- Mungon dokumentacioni për masat e sigurimit teknik dhe pajisjen me mjetet mbrojtëse përkatëse;
- Mungojnë provat me ngarkesë në lidhje me ndriçimin;
- Mungojnë provat me ngarkesë në lidhje me rrjetin e ujësjellësit.

II. Mangësitë në zbatimin e punimeve:

Kjo diferencë del si rrjedhojë e situacionimit të punimeve fiktive. Për objektin e mësipërm është kryer lidhja e kontratës shtesë nr. 1021/3 prot., datë 10.08.2016 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Ura Vajguore përfaqësuar nga kryetarja znj. Juliana Memaj dhe bashkimit të operatorëve ekonomik “T.B...” Shpk dhe “G.C...”. Nga verifikimi i zërave të punimeve të kësaj kontrate shtesë, rezulton se këta zëra punimesh janë punime të maskuara dhe jo sipërfaqësorë. Kontrata bazë ka përfunduar më datë 31.05.2016, ndërkohë që kontrata shtesë për punime të maskuara është lidhur në datën 10.08.2016. Gjithashtu situacioni përfundimtar i kontratës shtesë pasqyron se punimet janë kryer nga data 10.08.2016 deri më datën 31.08.2016 pa paraqitur asnjë dokumentacion shoqërues që ti justifikojë këta zëra punimesh. Nga verifikimi në terren i objektit, ka rezultuar së është e pamundur kryerja e këtyre punimeve shtesë pasi objekti është konsideruar i përfunduar më datë 31.05.2018. Prandaj lidhja e kësaj kontratë është kryer fiktivisht, duke mos reflektuar punimet e kryera sipas situacionit përfundimtar dhe grafikut të punimeve. Për rrjedhojë sipërmarresit ka përfituar më tepër vlerën **1,997,259 lekë pa tvsh** si pasojë e situacionimit të punimeve fiktive të kryera në kontratën shtesë.

Nga mbikëqyrësi i punimeve Ing. E.Ç. është vepruar në kundërshtim me:

- ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7,
- udhëzimin e KM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të KM “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 3.2 dhe 3.3

- Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pikat 3
- Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 4, paragrafi 4 ku përcaktohet dokumentacioni i nevojshëm në dosjen teknike.
- Kontratën për mbikëqyrjen e punimeve lidhur me Autoritetin Kontraktor Bashkia Himarë ku përcaktohen Detyrimet e mbikëqyrësit.

E. KALLËZIM PENAL:

Bazuar në kualifikimet e nenit 248 “Shpërdorimi i detyrës” të Kodit Penal dhe ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, bëjmë kallëzim penal për:

1. E.Ç. nën cilësinë e përfaqësueses ligjore të firmës “A. E...” Shpk.

Lidhur me dëmin ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit dhe njësisë së qeverisjes vendore si pasojë e situacionimit të punimeve fiktive gjatë zbatimit të kontratës në vlerën **1,997,259 lekë** për objektin “*Rehabilitim, Ndriçim, Gjelbërim i Shëtitores të Lagjes “18 Tetori”*”

Shënim: Bazuar në nenin 22 të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar”, i ndryshuar, Kallëzimi Penal nuk publikohet.

F. PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL:

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër (Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Institucionit), pasi të zbatohet procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.
2. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.

G. Auditimi i kryer në Bashkinë Ura Vajguore, vlerësohet dobët nga Kryetari i KLSH-së dhe prokurimet publike do të riauditohen në një kohë të dytë.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendor.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R